

VENDIM
Nr.39, datë 20.1.1997

PËR NJË SHITESË NË NUMRIN E PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS SË
PËRGJITHSHME TË NDIHMËS DHE SHËRBIMEVE SOCIALE

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Për nevoja të aktivitetit të shtëpisë së foshnjës në qytetin e Vlorës, administratës së përgjithshme të ndihmës dhe të çështjeve sociale për vitin 1997 i shtohen në organikë 33 punonjës.

Shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative të përballohen brenda buxhetit të vitit 1997 të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi